



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 87/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtruesa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të Qendrës së Votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega ne Ferizaj, ashtu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2150 (dymijë e njëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 29.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se në afërsi të shkollës "Ahmet Hoxha" në ora 10:00, në largësi më pak se 25 metra nga kjo Qendër e Votimit (QV) janë të vendosur posterë të Agim Aliut kandidat nga radhët e subjektit politik PDK. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast është shkelur nisi 85.1 i LZP-së si dhe nisi 6 paragrafi 1 i Rregullës Zgjedhore 09/2009.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografët e kandidatit për kryetar komune në Ferizaj nga radhët e subjektit politik PDK të vendosura në afërsi të shkollës filllore "Ahmet Hoxha" në Ferizaj.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it më datë 29.04.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 30.04.2012. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar në të cilën theksohet se pretendimet e LVV-së, nuk janë fakte të argumentuara sepse fotot e bashkangjitura në ankesë janë në një hapësirë krejt tjetër dhe aspak nuk kanë të bëjnë posterin kinse të vendosur pranë shkollës filllore Ahmet Hoxha, me propozim që ankesa e LVV-së të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë te cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se posterat e kandidatit për kryetar komune të Ferizajt Agim Aliu nga radhët e subjektit politik PDK janë të vendosura në afërsi më të vogël se 100 metra nga shkolla filliore "Ahmet Hoxha" ku ka qenë duke u zhvilluar procesi zgjedhor në ditën e votimit të datës 29.04.2012. Sipas Nenit 85 paragrafin 1 të LZP-së, *të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilit do VV ose QV në rreze prej 100 metra, çfarëdo materiali i tillë i mbetur 24 orë para fillimit të votimit duhet të largohen nga anëtarët e KVV-ve ose menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.*

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njofuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik PDK pa dyshim është shkelur dispozita e nenit 85 paragrafin 1 të LZP-së me atë se fotografitë e kandidatit të saj për kryetar komune janë vendosur në afërsi më të afërt se 100 metra nga kjo QV, si dhe faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 120 parografi 1 pika (c) të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP, nuk do t'i pranojë kërkësat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshire është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 87/2012 më datën 03.05.2012

